

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti Për Krime të Rënda, në përbërje të trupit gjykues gjyqtarëve Arben Hoti- kryetarë, dhe Afërdita Bytyqi dhe Suzana Çerkini anëtarë, me sek. Juridike Ibadete Zullufi, në çështjen penale kundër të pandehurve M.H., P.N.dhe D.Sh.-M., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Blerja, Posedimi, Shpërndarja dhe Shitja e Paautorizuar e Substancave Narkotike nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti Për Krime të Rënda, PP.I.nr.818/2015 të datës 15.01.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik të datës dt.05.04.2016, në të cilin ishin të pranishëm prokurori i shtetit Iliaz Beqiri, të pandehurit M.H. dhe mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare av.M.D., të pandehurit P.N.dhe mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare av. M. H., dhe të pandehurës D.Sh.-M. me mbrojtësit të tij sipas autorizimit av.B. T., pas seancës për këshillim dhe votim mori dhe publikisht komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

1. I pandehuri **M. H.**, nga i ati G. dhe nëna R., e gjinisë G., i lindur me *data e lindjes...* në D., me vendbanim në J., i martuar baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptarë shtetas i Republikës së Kosovës, ka qëndruar në paraburgim prej datës 15.10.2015 deri me dt.10.02.2016.
2. I pandehuri **P. N.**, nga i ati P. dhe nëna F., e gjinisë Q., i lindur me *data e lindjes...* në P., me vendbanim në, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal *numër personal...*, shqiptarë shtetas i Republikës së Kosovës.
3. E pandehura **D. Sh. – M.**, nga i ati I. dhe nëna N., e gjinisë R., e lindur me *data e lindjes...* në P., ku edhe etani jeton, i martuar, nënë e një fëmije, ka të kryer fakultetin Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, punon përkthyesë në KFOR, e gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal *numër personal...*, shqiptare shtetase i Republikës së Kosovës

JANË FAJTOR

Sepse:

Kanë blerë, poseduar, shpërndare dhe shitur substanca narkotike në mënyrë të paautorizuar, në atë mënyrë që i pandehuri M.H. pas marrëveshjes paraprake me të pandehurin P. N., është furnizuar dhe ka siguruar një sasi narkotiku nga një person nga Shqipëria, e pastaj me datën 15.10.2015 rreth orës 18:00, me veturën e tipit “Passat”, me targa *numër i targave...*, prej Junikut ka shkuar në Prishtinë, ku në rrugën “Imzot Nikë Prelaj” është takuar me të pandehurin P. dhe të njëjtit ia jep sasinë e marihuanës prej 1037 gram me çmim prej 1400 euro, dhe largohet nga vendi i ngjarjes, ndërsa i pandehuri P. sipas marrëveshjes me të pandehurën D., kthehet në banesë banesën e tij ku e priste e pandehura D., dhe meqë ishin në vëzhgimin e pjesëtarëve të policisë, të pandehurit P. dhe D., gjendet sasia e lartpërmendur e

narkotikut, e ndarë në pjesë dhe qese, një peshore digjitale, 12 fara të kanabisit, ndërsa te i pandehuri M. gjenden 1400 euro nga shitja e marihuanës.

-me këtë ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e substancave narkotike, parashikuar nga neni 273 par 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, gjykata bazuar në nenin e lartpërmendur dhe nenet 6,35,38,39,60,64,73,75 të KPK-së, si dhe nenit 365 të KPRK –së,

GJYKON DËNIM ME BURGIM

1. Të pandehurin **M.H.** me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit, e gjashtë (6) muaj, në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e qëndrimit në paraburgim prej datës 15.10.2015 deri me datë 10.02.2016, si dhe dënimin me gjobë në vlerë prej 1.000 euro, të cilën shumë i pandehuri detyrohet ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditës, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
2. Të pandehurin **P.N.** me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit, e gjashtë (6) muaj, si dhe dënimin me gjobë në vlerë prej 1.000 euro, të cilën shumë i pandehuri detyrohet ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditës, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
3. Të pandehurën **D. Sh. – M.** me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit, si dhe dënimin me gjobë në vlerë prej 1.000 euro, të cilën shumë e pandehura detyrohet ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditës, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Nëse të pandehurit nuk e paguajnë gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të zëvendësojë dënimin në gjobë ashtu që një ditë burgimi do të llogaritet me 20 euro gjobë të shqiptuar.

Konfrom nenit 62 par.2 nënpar.2.6 të dhe nenit 69 KPRK-së, dhe nenit 115 të KPPK-së konfiskohen:

- Vetura e markës “VË Passat Ttipi 3”, me targa *numër i targave...*, me numër shasië XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX, e përshkruar si në vërtetimin mbi sekuestrimin e sendeve të datës 15.10.2015.
- Parat në shumë prej 1400 euro në bankënota dhe apoena si në vërtetimin mbi sekuestrimin e sendeve të datës 15.10.2015.
- Konfiskohet sasia e narkotikut e llojit marihuan në sasi prej 1037 gram, si dhe 12 fara të kanabisit, të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit.
- Konfiskohet peshorja dixhitale me mbishkrimin “Studio”

Detyrohet të pandehurit që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë paushallin gjyqësorë secili veç e veç në shumë prej nga 50 euro, në afatin prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykim.

Ar sy e t i m i

Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Prishtinë, ka paraqitur aktakuzën PP.I.nr.818/2015 të datës 15.01.2015, kundër të pandehurve M.H., P.N.dhe D.Sh.-M., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Blerja, Posedimi, Shpërndarja dhe Shitja e Paautorizuar e Substancave Narkotike nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Duke vepruar në këtë çështje gjykata në mundësinë e parë ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar konform nenit 242 par.5 të KPPK-së meqenëse i pandehuri M.H. ka qenë nën masën e paraburgimit, ku prokurori i shtetit Iliaz Beqiri lexoj aktakuzë, ndërsa gjyqtari pasi u bind se të pandehurit e kanë kuptuar përmbajtjen e akuzës, kryetari i trupit gjykues të pandehurve u dha mundësinë të pranojnë fajësinë ose të deklarohen të pafajshëm.

Të pandehurit M.H. dhe P.N.në shqyrtimin fillestar e kanë pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën janë akuzuar.

Meqenëse të pandehurit M.H. dhe P.N.kanë pranuar fajësinë gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kriteret nga neni 248 par.1 të KPPK-së, sepse të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht dhe pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre të caktuar sipas detyrës zyrtare nga gjykata, pranimi mbështetet në provat dhe faktet që përmban akuza siç janë: Raporti i Ezaminimit të Substancës Narkotikë i dt.08.01.2016, Raporti mbi Këqyrjen e Vendit të Ngjarjes, Vërtetimi Mbi marrjen e Sendeve, foto dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës, andaj gjykata ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar fajësinë për të akuzuarit M.H. dhe P.N.për veprën penale Blerja, Posedimi, Shpërndarja dhe Shitja e Paautorizuar e Substancave Narkotike nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe ka shtyrë shqyrtimin e dënimit për të njëjtit.

Ndërsa e pandehura D. Sh. – M. në shqyrtimin fillestar nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, duke theksuar se nuk e pranon fajësinë sipas kualifikimit të veprës penale të bërë nga prokuroria, ndërsa ka theksuar se i pranon veprimet të përshkuara në dispozitivin e aktakuzës, ndërsa mbrojtësi i ta pandehurit sipas autorizimit Av.B. T. ka hequr dorë nga kundërshtimi i provave dhe kërkesa për hudhje të aktakuzës, duke i sugjeruar gjykatës që të procedohet me shqyrtimi kryesorë.

Shqyrtimi gjyqësorë dhe deklaratimet e palëve

Duke vepruar në këtë çështje penalo-juridike, konform nenit 326 par.5 të KPPK-së, shqyrtimi gjyqësorë ka vazhduar vetëm për të pandehurën D. Sh. – M., e cila po ashtu në shqyrtimin gjyqësorë është deklaruar e pafajshme për veprën penale me të cilën është akuzuar.

Shqyrtimi gjyqësorë ka vazhduar me fjalën hyrëse të palëve ku prokurori i shtetit ka theksuar ndër të tjera se e provat e propozuara nga prokuroria do të vërtetohet gjendja faktike si në aktakuzë.¹

Mbrojtësi i të pandehurës D. Sh. – M. Av.B. T., në fjalën e tij hyrëse ka deklaruar, citohet: *me provat të cilat janë siguruar gjatë procedurës së hetuesisë të cilat të tërat janë prova të*

¹ Procesverbali I dt.22.03.2016 fjala hyrëse e prokurorit të shtetit, e lexuar në seancën e datës 05.04.2016

pranueshme do të vërtetohet se e mbrojtura ime ka kryer veprën penale Posedimi i Paautorizuar Të Substancave Narkotike të parashikuar me nenin 275 par.1 të KPRK-së.²

Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësorë.

Në shqyrtimin gjyqësorë gjykata ka administruar të gjitha provat e propozuara nga ana e prokurorisë me aktakuzë, si dhe provat e propozuar nga mbrojtja e të pandehurës të cilat janë aprovuar nga trupi gjykues, e që janë:

- Raporti i Ekzaminimit të Substancës Narkotike
- Raporti Mbi Këqyrjen e Vendit të Ngjarjes i dt.15.10.2015
- Vërtetimi mbi Marrjen e Sendeve i dt.15.10.2015
- Foto dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës
- Raporti i mjekut nga klinika “S.”
- Raporti specialistik i ordinancës “R.” i dt.05.03.2016
- Raporti për ecurinë terapeutike të Qendrës “Labirint” i dt.14.03.2016

Mbrojtja e të pandehurës

E pandehura D. Sh. – M. pas konsultimit me mbrojtësin e saj, ka shfrytëzuar të drejtën që të mbrohet në heshtje.

Fjala përfundimtar e palëve

Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka theksuar se qëndron pranë aktakuzës dhe se i propozon gjykatës të shpallen fajtorë dhe të njëjtit të dënohen, ngase sipas prokurorisë është vërtetuar se të pandehurit kanë kryer veprat penale me të cilat janë akuzuar, në mënyrën dhe kohën ashtu siç është përshkruar në aktakuzë.³

Mbrojtësi i të pandehurit M.H. av. M. D. dhe mbrojtësi i të pandehurit P.N.av.M. H., të pandehur këta që e kanë pranuar fajësinë për veprën penale në shqyrtimin fillestar, po ashtu kanë paraqitur fjalën e tyre përfundimtare, ku të njëjtit meqë të mbrojturit e tyre kanë pranuar fajësinë, fjalën e tyre përfundimtare e kanë orientuar në potencimin e rrethanave lehtësuese për të mbrojturit e tyre, pra që kanë të bëjnë me matjen e dënimit, e të cilat fjalë përfundimtare i kanë përkrahur edhe të pandehurit.⁴

Mbrojtësi i të pandehurës D. Sh. – M. av.B. T. fjalën e tij përfundimtare e ka paraqitur me shkrim dhe të njëjtën e ka elaboruar shkurtimisht me gojë, ku mbrojtja e të pandehurës insiston se e pandehura ka kryer veprën penale Posedimi i Paautorizuar Të Substancave Narkotike të parashikuar me nenin 275 par.1 të KPRK-së. Po ashtu mbrojtësi i të pandehurës në fjalën e tij përfundimtare ka potencuar rrethanat të cilat kanë të bëjnë me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit për të mbrojturën e tij, duke potencuar varësinë e saj nga drogat, sëmundjen e saj, si rrethanat e saja familjare.

Gjetjet e Gjykatës.

Gjykata pas procedurës së provave, analizimit të tyre secilës veç e veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, e ka vërtetuar gjendjen e fakteve si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

² Procesverbali I dt.22.03.2016 fjala hyrëse e av.B. T., e lexuar në seancën e dt.05.04.2016

³ Procesverbali I dt.05.04.2016 fjala përfundimtare e Prokurorit të Shtetit

⁴ Procesverbali I dt.05.04.2016 fjala përfundimtare e av.M.D.dhe av.M. H.

Nga prova materiale Raporti i Ekzaminimit të Substancës Narkotike punuar nga Agjencia e Kosovës Për Forenzikë e dt.08.01.2016 është konstatuar se sipas karakteristikës morfologjike dhe përbërjes kimike është vërtetuar se substanca narkotike e konfiskuar është e tipit Kanabis (Marihuan) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC).

Nga Raporti Mbi Këqyrjen e Vendit të Ngjarjes i dt.15.10.2015, është vërtetuar fakti se pas marrjes së informacionit hetuesit e policisë kishin marrë urdhrin gojore nga Gjyqtarja e Procedurës Paraprake, dhe kishin kryer bastisje në banesën e të pandehurit P.N.në lagjen “U.” Hyrja X X/X banesa nr.X, dhe në banesën gjatë bastisjes kishin gjetur substanca të dyshuara narkotike Marihuan, ku pas ekzaminimit është vërtetuar se e njëjta është e tipit Kanabis (Marihuan) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), dhe atë e paketuar në disa qese në sasi të përgjithshme 1037 gram, një peshore dixhitale, medikamente metadon.

Nga Raporti Mbi Këqyrjen e Vendit të Ngjarjes është vërtetuar se ne dt.15.10.2015 gjatë bastisjes në vendin e ngjarjes në banesën e të pandehurit P.N. kishte qenë prezent vet i pandehuri P. N., si dhe e pandehura D. Sh. – M..

Gjendja e fakteve si në dispozitiv të aktgjykimit është vërtetuar edhe nga prova materiale Vërtetimi mbi Marrjen e Sendeve i dt.15.10.2015, ku nga të pandehurit janë sekuestruar provat materiale inkriminuese, sikurse sasia e narkotikut Kanabis (Marihuan) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), tableta Metadon, peshore dixhitale. Po ashtu nga Vërtetimi mbi Marrjen e Sendeve i dt.15.10.2015 për të pandehurin M.H. është vërtetuar se këtij të pandehuri i janë gjetur dhe sekuestruar shuma prej 1400 €, para këto nga shitja e narkotikut, të cilin narkotik i pandehuri M.H. ia kishte shitur të pandehurve P.N.dhe D. Sh. – M. sipas marrëveshjes paraprake.

Gjendja e fakteve vërtetohet edhe nga foto dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës, konkretisht ky foto dokumentacion është provë e cila e është provë shtesë, dhe është mbështetje e Raporti Mbi Këqyrjen e Vendit të Ngjarjes i dt.15.10.2015, dhe Vërtetimi mbi Marrjen e Sendeve i dt.15.10.2015, ku hetuesit me rastin e kryerjes së këtyre operacioneve përveç mbajtjes së procesverbaleve kanë bërë edhe foto dokumentacion, ku shihen fare qartë provat materiale inkriminuese për të pandehurit, po ashtu këto prova vërtetohen edhe në bazë të video incizimit që është pjesë e shkresave të lëndës.

Pra nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësorë, është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit edhe sa i parket të pandehurës D. Sh. – M., pasi që të pandehurit M.H. dhe P.N.e kanë pranuar fajësinë për veprën penale gjatë shqyrtimit fillestar.

Nga Raporti Mbi Këqyrjen e Vendit të Ngjarjes i dt.15.10.2015 është vërtetuar se ditën kritike kur të pandehurit e kanë kryer veprën penale e pandehura D. Sh. – M. ishte prezente në banesën e të pandehurit P. N.. Sipas marrëveshjes paraprake pasi që e pandehura D. kishte siguruar shumën e parave për blerjen e narkotikut, paratë ia kishte dhënë të pandehurit P. ndërsa ky i fundit kishte pasur marrëveshje paraprake me të pandehurin M.H. i cili kishte siguruar sasinë e narkotikut nga një person nga Shqipëria, ku narkotikun e kishin shkëmbyer ditën kritike me dt.15.10.2015 rreth orës 18:00.

Se e pandehura D. kishte siguruar mjetet për blerjen e narkotikut, dhe për këtë gjë ishte marrë vesh me të pandehurin P. vërtetohet nga deklaratat e të pandehurës dhënë në Prokurorinë Themelore në Prishtinë me dt.04.12.2015 ku në praninë e mbrojtësit ka deklaruar; *unë 1700 euro me të cilën kam menduar të siguroj marihuanën i kam marrë nga një kolegë i imi në vendin e punës në KFOR dhe të njëjtat është dashur t'ia kthej pas një jave deri sa të më lejohet një kredi. Unë P. N. e njoh si qytetarë i Prishtinës, por edhe në periudha të caktuar*

kohore kemi konsumuar marihuan bashkë. Unë M. H. nuk e njoh fare dhe nuk e di se ku e ka siguruar P.N. atë sasi të drogës.

Fakti se të pandehurit e kanë kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e substancave narkotike, parashikuar nga neni 273 par 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, vërtetohet duke i bërë një analizë veprës penale për të cilën të pandehurit janë shpallur fajtorë, e cila thotë: *kushdo që pa autorizim, shpërndan, shet, transporton, dorëzon, ndërmjetëson, dërgon ose dërgon në transit substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotik, substanca psikotrope ose analoge, me qëllim të shpërndarjes shitjes ose ofrimit për shitje, dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy deri në dymbëdhjetë vjet.*

Pra formë e kryerjes së kësaj vepra penale, apo element i kësaj vepra penale është; shpërndarja, shitja, transportimi apo dërgimi me qëllim shpërndarje, shitje ose ofertë për shitje të narkotikëve. Secili nga këto veprime paraqet formë të posaçme me të cilin kryhet kjo veprë penale, të cilat veprime manifestohen në veprimet e të pandehurve të kryera në bashkëkryerje.

Meqenëse të pandehurit M.H. dhe P.N.e kanë pranuar fajësinë gjykata do të analizoj dhe përmes argumenteve do të provoj vetëm elementet inkriminuese për të pandehurën D..

Bashkëkryerja si formë e kryerjes së veprës penale e paraparë me nenin 31 të KPRK-së i cili nen thotë: *nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprë penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënim të paraparë për atë veprë penale.* Pra e pandehura D. duke qenë edhe porositëse edhe financuese, ka marrë pjesë në kryerjen e veprës penale, dhe i ka kontribuar thelbësisht kryerjes së saj, kështu që veprimet e të pandehurës D. së bashku me veprimet e të pandehurve M. dhe P. shprehet një aktivitet i përbashkët funksional në tërë zingjirin e ngjarjes lidhur me veprën penale të cilën e kanë kryer.

Nuk ka dyshim se e pandehura D. e ka porositur narkotikun dhe ka siguruar mjetet monetare sipas marrëveshjes, (pra ka qenë edhe inicuesja dhe promotrorja e aktivitetit kriminal) ku më pas i pandehuri P. ka marrë për detyrë ta siguroj narkotikun, duke qenë në dijeni se i pandehuri P. këtë sasi do ta siguroj nga një person tjetër, e që në rastin konkret është i pandehuri M.H.. Pra në mes të bashkëkryerësve ekziston edhe Lidhja Objektive ngase ashtu siç u tha më lartë veprimet e tyre paraqesin një aktivitet të përbashkët funksional, por ka ekzistuar edhe lidhja subjektive ngase e pandehura D. ka qenë në dijeni se i pandehuri P. nuk e posedon narkotikun por atë do ta siguroj nga një person tjetër, dhe nuk është me rëndësi fakti se e pandehura D. a është njohur drejtpërdrejtë me të pandehurin M.H., dhe kjo është arsyeja që nuk qëndrojnë pretendimet e mbrojtësit të pandehurës D. av.B. T. se e mbrojtura e tij ka kryer veprën penale Posedimi i Paautorizuar Të Substancave Narkotike të parashikuar me nenin 275 par.1 të KPRK-së, për vet arsyet e cekura më lartë, pra *bashkryerjes*, por edhe sasisë së narkotikut që është konfiskuar në vendin e ngjarjes e që është e një sasi të konsiderueshme, duke marrë këtu edhe faktin e vërtetuar se në vendin e ngjarjes është gjetur edhe një peshore digjitale, janë vërtetuar pretendimet e aktakuzës, dhe fakti se e pandehura D. është konsumuese e substancave narkotike, nuk është rrethanë që i deinkriminon veprimet e saja.

Këto janë arsyet nga të cilat është vërtetuar se në veprimet e të pandehurës manifestohen elementet e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e substancave narkotike, parashikuar nga neni 273 par 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe jo elementet e veprës penale Posedimi i Paautorizuar Të Substancave Narkotike të parashikuar me nenin 275 par.1 të KPRK-së.

Vendimi mbi dënimin

Me rastin e marrjes së vendimit për dënimin për të pandehurit gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit.

Meqenëse të pandehurit M.H. dhe P.N.e kanë pranuar fajësinë në të gjitha fazat e procedurës, gjykata këtë pranim fajësie e konsideron si rrethanë posaçërisht lehtësuese, andaj aplikoj dispozitën e nenit 75 par.1 nënpar.1.3 duke i shqiptuar të pandehurve dënim nën kufirin e paraparë me ligj, pastaj si rrethana tjera lehtësues për të pandehuri gjykata ka marrë keqardhje e shfaqur nga të pandehurit për veprën e kryer, si dhe rrethanat e tyre familjare.

Ndërsa për të pandehurën D. Sh. – M. e cila nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën është akuzuar, ndonëse e njëjta i ka pranuar veprimet të përshkruara në dispozitiv, gjykata me rastin e marrjes së vendimit për mori parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethana lehtësuese gjykata për këtë të pandehur ka marrë parasysh faktin se nuk ka të dhëna se e pandehura ka qenë e dënuar më parë për vepra penale, rrethanat e saja familjare, e njëjta është nënë vetushqyese e një fëmije, dhe rrethanat personale – shëndetësore, ku në bazë të dokumentacionit shëndetësorë të propozuar nga mbrojtja dhe e administruar në seancë gjyqësorë vërtetohet se e njëjta është përdoruese kronike e substancave narkotike, dhe vuan nga probleme të shumta shëndetësore, rrethana këto që gjykata i konsideron si posaçërisht lehtësuese, që dallojnë nga rrethanat e rëndomta lehtësuese ngase dallohen nga ato për nga intensiteti i tyre. Pra e pandehura duke qenë e varur kronike nga substancat narkotike, ka qenë në kërkim të vazhdueshëm për substanca narkotike dhe kjo vërtetohet në bazë të dokumentacionit mjekësor sikurse janë Raporti i mjekut nga klinika “S.”, Raporti specialistik i ordinancës “R.” i dt.05.03.2016, Raporti për ecurinë terapeutike të Qendrës “L.” i dt.14.03.2016, ku nga përdorimi i këtyre substancave e pandehura ka dëmtime në shumë organe vitale në organizëm, andaj të gjitha këto rrethana e bëjnë veprën penale më të lehtë, tregojnë se e pandehura nuk është një delikuede e rrezikshme, dhe tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me dënim më të butë, andaj gjykata për këtë të pandehur ka zbutur dënimin nën kufirin e paraparë ligjorë, konform nenit 75 par.1 nënpar.1.2 të KPRK-së, duke i shqiptuar dënim edhe më të butë se dy të pandehurit e parë, duke bërë individualizimin e dënimit.

Mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjesisë penale të secilit të pandehur veç e veç, dhe rrezikshmërinë konkrete të kësaj vepre penale, duke qenë e bindur se me dënimin si në pjesën dënuese të këtij aktgjykimi, do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventives speciale, dhe ky dënim të ndikoj te të pandehurit që ata të përmbahet nga përsëritja e veprave penale, po ashtu të arrihet edhe qëllimi ndëshkimorë në kuptim të preventives gjenerale, që dënimi i shqiptuar të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e të dëmtuarve për dëmet e shkaktuara nga vepra penale, por edhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit, dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për konfiskim

Gjykata Konfrom nenit 62 par.2 nënpar.2.6 të dhe nenit 69 KPRK-së, dhe nenit 115 të KPPK-së ka konfiskuar Veturën e markës “VW Passat Tipi 3”, me targa *numër i targave...*, me numër shasie XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX, e përshkruar si në vërtetimin mbi sekuestrimin e sendeve të datës 15.10.2015, parat në shumë prej 1400 euro në bankënota dhe apoena si në vërtetimin mbi sekuestrimin e sendeve të datës 15.10.2015, si dhe sasinë e narkotikut e përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës, si dhe peshoren dixhitale me mbishkrimin “Studio”,

si mjete të përdorura për kryerje ne veprës penale. Gjithashtu bazuar në nenin 274 par.5 të KPRK-së konfiskimi i substancave psikotrope ose substancave analoge dhe mjeteve për prodhimin, shpërndarjen apo transportimin e tyre konfiskohen, pra kjo është dispozitë imperative, andaj pavarësisht se i pandehuri M.H. ka prezantuar dokumentacion se vetura e markës “VW Passat Tipi 3”, me targa *numër i targave...*, është veturë e marrë me qera nga i pandehuri, pavarësisht kësaj vetura në fjalë është mjet me të cilin është kryer vepra penale, konkretisht është transportuar substanca narkotike, dhe ashtu siç u cek konfiskimi në këtë rast është imperativ në bazë të dispozitës ligjore të përmendur, dhe nuk lidhet me pronësinë e saj.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nen. 454 par.1. të KPPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË PKR.nr. 20/16 të dt. 05.04.2016

Sek.juridike:
Ibadete Zullufi

Gj y q t a r i:
Arben Hoti

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.